



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL DURRËS

NR. Prot _____

Data ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

- Objekt i procedurës kryesore: "Blerje material konsumi për Spitalin Rajonal Durres – Marreveshje Kuader, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara, me afat 12 muaj",
- Fondi limit në total/vlera e pritshme e kontratave të MK: 5,777,090 (pese milion e shtateqind e shtatedhjetë e shtate mije e nentëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Durres** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori ekonomik.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një **xhiro vjetore minimale** të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”; si dhe ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1.*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të **xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c)*

40% te vleres se perllogaritur te kontrates ose lotit ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 i ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 KAPACITETI TEKNIK:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Certifikatë ISO 9001/ose/ ekuivalent ISO 13485 "Per Sistemin e menaxhimin te cilesise"** /ose ekuivalent të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë **Vetëdeklarim** ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 44, pika 3, 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.2 Ofertuesi duhet te jete i **certifikuar me ISO 9001:2015 ose ekuivalente të vlefshme**, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit.

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 44, pika 3, 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.3 **Vetedeklarim** se te gjitha materialet (tubat dhe aksesoret) nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) **jane konform me normat MDD 93/42/EEC** (të përditësuar) ose 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e **certifikatave** përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 44, pika 3, 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizim** nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 **Vetedeklarim** i operatorit ekonomik lidhur me origjinen e mallit, ku te percaktohet qarte vendi dhe kompania prodhuese.

Argumentimi: Kjo kerkese vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter eshte ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.6 **Deklarate** qe verteton se operatori ekonomik disponon te gjithe sasine per secilen nga materialet e kerkuara nga AK dhe do ta vere ne dispozicion te Autoritetit sipas kerkesave te ketij te fundit.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim** të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar pika 2 " *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*" Si dhe ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40 pika 5 "a) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*".

2.3.8 Kërkohen të paraqiten **katalogë** teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku shprehet rrjedhimisht: "6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b) fotografitë apo katalogët teknikë".

2.3.9 Kërkohen të paraqiten **mostra** për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Durres, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: "Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi ne oren dhe daten e hapjes se tenderit.

Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti, e cila do të dorëzohet per protokoll ne sekretari. Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku shprehet rrjedhimisht: "6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë*

dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

TABELA NR. 1

Nr.	Emertimi	Volumi, Permasat	Shenime	njesia	sasia e parashiku ar per 12 muaj
1	Tub me trisodium citrate plasma (0,109M, 3,2% per teste koagulimi. Sistem i mbyllur me vakum. Tape bojeqielli	2,7 - 4,5ml 13x75mm		cope	14,000
2	Tuba me xhel per serum, me aktivator koagulimi te shpejte. Sistem i mbyllur me vakum. Tape Portokalli/e kuqe	5ml, 13x100mm	Ndares me xhel, koha e koagulimit jo me shume se 10 minuta	cope	18,000
3	Tuba me xhel me serum me aktivator kogulimi me kohe jo me te madhe se 30 minuta. Sistem i mbyllur me vakum. Tape e Verdhe/e Kuqe.	5 ml, 13x 100mm	Ndares me xhel	cope	26,000
4	Tuba me K2EDTA (Dipotaassium) per teste hematologjike. Sistem i mbyllur me vakum. Tape Lejla	3-4 ml, 13x75mm		cope	2,000
5	Tuba me K3 EDTA. Sistem i mbyllur me vakum. Tape Lejla	3-4 ml, 13x75mm		cope	8,000
6	Tub me sodium citrat per matjen e eritrosedimentacioit (ESR). Tape e zeze	1,6-5ml	Te shoqerohet me stative mbajtes /mates ose me aparatura atomatika te	cope	2,000

			matjes se ESR me kapacitet jo me pak se 60 teste ne ore		
7	Tub pediatrik me K2/K3EDTA per hematologji	me volum 250-500 µl	Te pershtatshem per analizatoret automatik te gjakut	cope	3600
8	Tub pediatrik me xhel per serum	me volum 400-1000 µl	Te pershtatshem per analizatoret automatik te gjakut	cope	2,400
9	Set Age per marrje gjaku, te pershtatshem per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar	21G, gjatesia e gjilperes 19mm, gjatesia e tubit jo me e vogel se 17cm.	Rekomandohen sisteme te ages me kapuc per te shmangur kontaminimin dhe me buton terheqes se ages per mbrojtje e personelit nga shpimi aksidental	cope	30,000
10	Shiringe per marrje gjaku me litium heparine	1-3 ml, 21-22G	E pershtatshme per gazet ne gjak	cope	6,500
11	Zhgut (llastik) per shtrengimin e krahut ku do merret gjaku			cope	200
12	Kontenier plastik steril per koleksionimin e urines me kapak dhe vidhosje qe mbyllet fortesisht	30-60ml, bosh.	Gotat te jene individualisht te paketuara	cope	6,000
13	Tub me terren per transportin dhe ruajtjen e urines me permbajtje te acidit borik	4-10 ml	per transport dhe ruajtje te mostrave te urines deri ne 48 ore	cope	300
14	Kontenier plastik per koleksionimin e feces i pajisur me spatul dhe kapak dhe vidhosje qe mbyllet fortesisht	20-30 ml bosh	Bosh	cope	1200
15	Kontenier me terren ruajtes te pershtatshem per koleksionimin e feces per testim parazitologjik	30-40ml	terren me permbajtje 10% formaline fiksuese ose ekuivalent	cope	1,000
16	Kit per koleksionimin dhe ruajtjen e mostrave rektale dhe feces, i perbere nga tamponi dhe tubi me terren Carly Blair	Tampon me tub me terren	i rekomanduar per rastet kur mostra fekale nuk mund te sigurohet ne rruge tradicionale	cope	1000
17	Kit steril i pershtatshem per marrjen e mostrave vaginale, fytyr, te lekures, te plageve i	Terren ruajtes me xhel agar Amies ose Stuart me dhe	Tamponet te jene me bisht plastik dhe maje me	cope	900

	pajisur me tampon dhe terren ruajtes per aerobe, anaerobe.	pa charcoal ose ekuivalent	permase normale. Kiti mund te perfshije nje ose 2 tampone dhe tubin me terren. Te kene paketim individual per cdo kit.		
18	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol. 120 ml - vol 150 ml		cope	500
19	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol. 500 ml		cope	1000
20	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol. 1000 ml		cope	500
21	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol. 3000 ml		cope	500
22	Furce per marrje materiali cervikal per testim PAP- test			cope	500
23	Xhama Objekt mbajtes	Fund i zmeriluar		cope	500
24	Xhama Objekt mbulues	24 mm * 50 mm		cope	500
25	Kontenitor i vogel steril bosh me kapak kunder rrjedhjes per marrje ne biopsy velikide te palces kurrizore, biopsive renale, te gjirit etj.	Rreth 60-90 ml		cope	300
26	Shishe e gatshme per hemokultur			cope	1500

Kerkesat Teknike dhe Standartet e Sistemit te Marrjes se Gjakut ne perputhje me Teknologjine e perdorur nga Konkensionari.

1. Tubat dhe aksesoret e tubave duhet të jenë të markuara CE ose FDA për të siguruar kualitetin e produktit.
2. Tubat e gjakut duhet të jene ne perputhje me “Direktiven europiane te pajisjeve mjeksore per diagnostiken in vitro 98/79/EC” ose ekuivalente, me normat MDD 93/42/EEC (të përditësuar) ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.
3. Tubat dhe aksesoret duhet të jene te sterilizuara.
4. Tubat dhe aksesoret e tubave duhet të jene e nje sistemi te mbyllur ne marrjen e gjakut ne perputhje me kerkesat e OBSH dhe CLSI.
5. Tapat e tubave te jene me ngjyra te percaktuara sipas rekomandimeve te EFLM ne varesi te disiplinave laboratorike ku ato do perdoren.
6. Tapat e tubave te rutines duhet te mbyllen nga nje sistem i pajisur me nje gome unike e cila izolon tubat e mbledhjes se gjakut. Ajo duhet te jete e futur nga brenda dhe e mbuluar nga nje mburoje plastike per te ndihmuar ne mbrojtjen e personelit mjeksor nga kontakti me gjakun ne pjesen e tapes ose ne skajet e jashtme te tubit. Nje mbyllje e tille ben te mundur qe gjaku mos sperkatet/perhapet kur tubi hapet. Te sillen mostra per t’u provuar nga laboratorit.
7. Tubat duhet të kene te shenuar volumin e mbushjes dhe nivelin e mbushjes.

8. Tubat duhet te kene te shenuar daten e skadences, simbolin e sterilizimit, lotin perkates dhe tipin e antikoagulimit/aditivit qe permbajne.
9. Tubat dhe aksesoret e marrjes se gjakut duhet te jene njeperdorimesh.
10. Tubat e perdorur ne kimine klinike, hematologji dhe koagulim duhet patjeter te kene perberje te materialit plastik te pathyeshem PET ne menyre qe te shmanget risku i thyerjes apo plasaritjes se tyre gjate centrifugimit.

Data e Skadences: Data e skadencës për materialet mjekësore objekt prokurimi, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës, ose jo me pak se nje vit nga data e levrimit te mallit. Perjashtim bejne tubat te cilat duhet të lëvrohen cdo tre muaj për shkak të skadencës së vogël që e kanë si pasojë të sistemit të mbyllur. Në momentin e lëvrimit të kenë skadence jo me të vogël se 5 muaj.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne Ligjin nr.105/2014 *“Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik” te ndryshuar* ku percaktohet qe bari per perdorim ne RSH duhet te jete brenda afatit te skadences per tregtim.

Afatet e Levrimit: sipas kerkesave te AK.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Argumentimi per specifikimet teknike jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike dhe perllogaritjes se fondit limit me nr. 485/4 prot., dt. 19.04.2024 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 485/2 prot., dt. 20.03.2024 i ndryshuar, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38 te Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe neneve 20 dhe 49 te Ligjit nr. 105/2014 *“Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”*.

Argumentimi i fondit limit: Ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike dhe perllogaritjes se fondit limit me nr. 485/4 prot., dt. 19.04.2024 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 485/2 prot., dt. 20.03.2024 i ndryshuar, argumentohet nga grupi i punes qe: Per llogaritjen e fondit jemi bazuar sipas VKM 285 datë 19/05/2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te ndryshuar sipas nenit 76 /1 sipas te cilit: *“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatoreve ekonomik

Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës “Blerje materiale konsumi laboratorik” sipas studimit

te tregut si me poshte: Ne përcaktimin e sasive për laboratorin, Komisioni u bazua në parashikimin e bere nga ana e Komisionit AD HOC të ngritur sipas Urdherit me Nr. 1114/11 prot, date 27.10.2023, për një periudhë 12 mujore sipas planifikimit me Nr. 1698/2 prot., date 15/12/2023 “Kerkese për materiale konsumi laboratorik”. Për sa me sipër Komisioni pas marrjes së ofertave “çmimet për njësi për cdo ze” nga disa operator ekonomik nepermjet komunikimit elektronik, ka përgatitur tabelen për llogaritjen e fondit limit. Përsa i përket materialit të konsumit laboratorik nr. 26 shishe e gatshme për hemokulture, nga testimi i tregut rezultoi vetëm një oferte, komisioni është bazuar vetëm tek ajo oferte për t'i siguruar shërbimit të infektivit materialin e domosdoshëm për kryerjen e analizës.

U ngarkua në sistemin e prokurimit elektronik nga njesia e prokurimit: